



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
OSNOVNI SUD U PRIZRENU – BASIC COURT OF PRIZREN

ADGJTHP.nr.5/2022

GJYKATA THEMELORE PRIZREN, U.D. Kryetari i Gjykatës Artan Sejrani, në çështjen e hetimit disiplinor ndaj gjyqtarit A.H., sipas ankesës për iniciimin e procedurës disiplinore të parashtruar nga E.P., nga Prizreni, me datë 04.05.2022 mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pa bazuar ankesa e parashtruar nga E.P.; nga Prizreni, për iniciimin e procedurës disiplinore ndaj gjyqtarit A.H.; e parashtruar në këtë Gjykatë me datë 12.04.2022.

A r s y e t i m

Me datë 12.04.2022 (përmes e-mailit), parashtruesja e kërkesës pranë kësaj Gjykate ka parashtruar ankesë për iniciimin e procedurës disiplinore ndaj gjyqtarit të lartcekur. Në vazhdim në ankesë, parashtruesja ndër të tjera ka theksuar se si palë e dëmtuar ka kërkuar nga institucioni i drejtësisë për anulimin e vendimit ku i është bërë padrejtësi me marrjen me dhunë të orëve të ligjërit nga ajo që është e profesionalizuar pa asnjë marrëveshje, informatë apo të paktën një njoftim paraprak. Kërkesa e saj nuk është analizuar drejtë nga gjykatësi dhe në fund i është refuzuar padia, ku ka përfunduar e dëmtuar dhe fajtoje edhe nga shkolla edhe nga gjykata. Në drejtësinë që ka besuar shumë, e ka hedhur në humnerë, përderisa ajo ka besuar në drejtësi dhe gjithmonë ka kërkuar drejtësi. Me një vendosje të tillë, gjykatësi në gjykatën e shkallës së parë i ka cenuar të drejtën e punës sipas kontratës dhe dispozitave ligjore në fuqi që përcakton Ligji i Punës, pasi që nuk e ka anuluar vendimin e të paditurës, i marrë pa bazë ligjore dhe formë diskriminuese, ku në këtë çështje kontestimore ka parashtruar edhe prova të tjera të cilat janë diskriminim në vendin e punës, dëm moral i shkaktuar nga marrja e këtij vendimi në formë të vazhdueshme me ftesa në komision disiplinor dhe shqiptimin e vërejtjes e cila mund të pasojë me largimin nga puna. Dhe në fund kërkon që të hetohet rasti pasi që ka dyshime tek gjykatësi me vendimin e marrë në mënyrë jo të drejtë që i ka shkaktuar thyerje të moralit, ndjenjë keqtrajtuese dhe humbje besimi në organet e drejtësisë.

Gjyqtari A.H., lidhur me ankesën e parashtrueses në deklaratën e tij ka theksuar se duke vepruar me urgjencë për t'ia proceduar lëndën kontestimore, së fundmi pas mbajtjes së seancës kryesore dhe pas hartimit me shkrim të aktgjykimit C.nr....., të datës 31.03.2022, si gjykatës i çështjes sipas bindjes së lirë dhe duke respektuar të gjitha palët në procedurë pa dallim në këtë lëndë kontestimore dhe në bazë të provave të cilat gjenden në shkresat e lëndës dhe gjendjes së tyre në kohën e vendosjes ka vendosur që kërkesëpadinë e paditëses E.P., t'ia refuzojë në tërësi si të pa bazuar. Në vazhdim ka shtuar se ankesa e paditëses si dhe arsyet e dhëna në këtë ankesë janë të pa bazuar dhe se e njëjta ka të drejtën e ankesës ndaj aktgjykimit të kësaj gjykate C.nr....., të datës 31.03.2022, ndërsa nuk e komenton mënyrën e vendosjes së tanishme në bazë të aktgjykimit të cilën e ka nxjerr në këtë çështje kontestimore dhe se mënyra e vendosjes dhe arsyet e marrjes së këtij aktgjykimi i ka bazuar në ligj si dhe provat që gjenden në shkresat e lëndës, ndërsa mënyrën e tillë të vendosjes mund ta vlerësojë vetëm gjykata e instancave më të larta gjyqësore, e kursesi gjyqtari e as pala paditëse si ankuese, por edhe askush tjetër nuk kanë të drejtë të komentojnë aktgjykimin e dhënë në këtë çështje kontestimore.

U.D. Kryetari i Gjykatës pas hetimit paraparak, shikimit në shkresat e lëndës C.nr.2293/21, analizimit të kërkesës së parashtrueses së ankesës, deklaratën e gjyqtarit, konstaton se ankesa është e pa bazuar dhe e njëjta duhet të refuzohet si e pa bazuar.

U.D. Kryetari i gjykatës fillimisht konstaton se çështja civilo-juridike C.nr....., në punë është ndarë gjyqtarit A.H., në të cilën parashtruesja e ankesës është në cilësi të palës paditëse dhe se gjyqtari pas trajtimit të kësaj çështje civilo-juridike ka marrë aktgjykimin nën numrin C.nr..... të datës 31.03.2022, me të cilën është refuzuar si e pa bazuar kërkesëpadia e paditëses. Ndërkaq, në rastin konkret parashtruesja në pretendimet e saj në ankesës pretendon se gjyqtari i çështjes nuk e ka analizuar drejtë çështjen e saj dhe me një vendosje të tillë i është cenuar e drejta e punës sipas kontratës së punës dhe dispozitave të Ligjit të punës, me mos anulimin e vendimit të paditurës.

Sipas vlerësimit të U.D. Kryetarit të gjykatës, pretendimet e parashtrueses në ankesë janë të pa bazuara, duke vlerësuar se të njëjtat nuk janë as objekt i shqyrtimit nga kryetari i Gjykatës. Në ankesë disiplinore të parashtruar nga parashtruesja vihet në dukje një pakënaqësi lidhur me vlerësimin e provave dhe vendimin të cilin e ka marrë gjykatësi i çështjes. Për më tepër, në kërkesë nuk është theksuar ndonjë rrethanë apo shkelje e caktuar të gjyqtarit të çështjes ashtu edhe siç parashihet me dispozitat ligjore të ligjit 06/1-057 për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve. Më tutje në ankesën nuk ka një përshkrim konciz të aspekteve faktike dhe juridike mbi të cilat është ngritur dyshimi për shkelje disiplinore kundër gjyqtarit në fjalë. Përveç kësaj, duhet të theksohet se nuk është vërtetuar se ka pasur shkelje të kodit të etikës apo veprime të qëllimshme të gjyqtarit, apo ndonjë neglizhencë në punën e tij, para se gjithashtu duke marrë parasysh vëllimin e madh të lëndëve të cilat i kanë në punë gjyqtarët e kësaj gjykate, nga shkresat e lëndës del se kjo çështje kontestimore është trajtuar me urgjencë ashtu siç edhe parashihet me ligj. Në këtë drejtim U:D., i Kryetarit të gjykatës vlerëson se, në rastin konkret nuk kemi të bëjmë

me asnjë njëanshmëri të gjyqtarit të çështjes ndaj palës në këtë çështje juridike, para se gjithash gjyqtari është i obliguar që me ligj të mbroj dhe respektoj parimin e paanshmërisë dhe objektivitetin në procedurë gjyqësore, ndërsa për të drejtat dhe detyrimet në zbatimin e procedurës civile të gjyqtarit vendosin organet dhe institucionet gjyqësore të parapara me ligji, nëse ushtrohet mjete juridik.

Andaj, siç u theksua më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në pajtim me nenin 9 par.6 lidhur me nenin 17 par.5 të ligjit nr. 06/1 - 057 për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
ADGJTHP.nr.5/2022 më datë 04.05.2022



KËSHILLE JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.